



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë **30.07.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “a) Marrjen në pyetje të personit nën hetim **Ledio Ferzaj**; b) Verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit dhe nevojave të sigurimit për personin nën hetim **Ledio Ferzaj** dhe vazhdimin e masës së sigurimit *“arrest në shtëpi”*, të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale *“Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”*, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Bani, bazuar në nenet 112 dhe 248 të K.Pr.Penale, me vendimin **Nr. 93, datë 01.08.2024**, vendosi:

1. Vazhdimin e masës së sigurimit *“arrest në shtëpi”* parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj personit nën hetim **Ledio Refit Ferzaj** me vendimin Nr. 90, datë 28.07.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në bashkëpunim me policinë gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda **5 (pesë) ditëve**, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më datë 02.08.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar